

1 E premte, 18 dhjetor 2020

2 [Paraqitja e Parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Haradinaj hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve
7 brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, ju lutem të paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda KSC-
10 BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe
11 Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
13 Sekretare.

14 Tani do t'u kërkoj palëve që të prezantohen. Do të filloj
15 me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar
17 Gjykatës. Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar të pranishëm
18 sot janë, Jack Smith, Prokuror i Specializuar; Angel
19 Langenberg, që është ndihmës për prova dhe për administrimin e
20 çështjes; Nathan Quick, ndihmës juridik; dhe unë jam Valeria
21 Bolici, prokurore në Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

23 Tani fjalën e ka Mbrojtësi.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes i nderuar Gjykatës.

25 Toby Cadman për z. Haradinaj.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman. Për
2 procesverbalin i pranishëm në sallë është klienti juaj z.
3 Haradinaj.

4 Tani fjalën ia jap znj. Administratore.

5 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]
6 Mirëmëngjes. Fidelma Donlon, Administratore.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Dhe për hir
8 të procesverbalit përmend këtu që jeni e pranishme me anë të
9 videolidhjes.

10 Unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake
11 në këtë çështje.

12 I akuzuari paraqitet sot para Dhomave të Specializuara
13 pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij më 11 dhjetor.

14 Z. Haradinaj, në paraqitjen e parë në shtator kërkova
15 prej jush që të identifikonit veten, kështu që do të vazhdoj
16 drejtpërsëdrejti me historikun procedural në këtë çështje.

17 Më 24 shtator 2020, lëshova fletarrestim kundër të
18 dyshuarit pasi konstatova se ekziston dyshim i bazuar që z.
19 Haradinaj është penalisht përgjegjës për veprat penale të
20 mëposhtme: frikësim gjatë procedurës penale; hakmarrje; dhe
21 shkelje të fshehtësisë së procedurës.

22 I dyshuari u arrestua në Kosovë më 25 shtator 2020 dhe u
23 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
24 Specializuara të Kosovës në Hagë më 26 shtator 2020.

25 Më 11 dhjetor 2020, në cilësinë time të Gjykatësit të

1 Procedurës Paraprake, konfirmova aktakuzën e parashtruar nga
2 Prokurori i Specializuar kundër të akuzuarit, në të cilën ai
3 akuzohet për veprat penale të mëposhtme:

4 Pika 1: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
5 detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë;

6 Pika 2: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
7 detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e
8 përbashkët të një grupi;

9 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale;

10 Pika 4: Hakmarrje;

11 Pika 5: Shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes
12 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të
13 nxjerrë në procedura zyrtare; dhe

14 Pika 6: Shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes
15 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
16 personale të dëshmitarëve të mbrojtur.

17 Aktakuza e Konfirmuar iu dorëzua të akuzuarit të hënën më
18 14 dhjetor.

19 Tani më lejoni të shpjegoj qëllimin konkret të Paraqitjes
20 së Parë për nevojat e të akuzuarit dhe atyre që ndjekin
21 seancën nga galeria publike dhe online.

22 Seanca e sotme nuk është gjykim. Në këtë seancë nuk do të
23 paraqiten e as të debatohen prova, dhe fajësia apo pafajësia e
24 të akuzuarit nuk do të diskutohet dhe as nuk do të merret
25 vendim në lidhje me të. Qëllimi i kësaj Paraqitje të Parë

1 përcaktohet në nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92 të

2 Rregullores.

3 Në pajtim me këto dispozita, unë si Gjykatës i Procedurës
4 Paraprake: ia lexoj të akuzuarit akuzat e paraqitura në
5 Aktakuzën e Konfirmuar në një gjuhë që ai e kupton dhe flet;
6 konfirmoj që i akuzuari e kupton aktakuzën; bindem se të
7 drejtat e të akuzuarit, dhe veçanërisht e drejta e tij për të
8 pasur avokat mbrojtës janë respektuar; informoj të akuzuarin
9 se brenda 30 ditësh nga dita e seancës së sotme ai do të
10 ftohet të vetëdeklarohet fajtor ose i pafajshëm në lidhje me
11 secilën akuzë të paraqitur në aktakuzë. Në qoftë se i akuzuari
12 dëshiron, ai mund menjëherë të vetëdeklarohet lidhur me
13 fajësinë ose pafajësinë. Dhe së fundi, caktoj data të tjera
14 sipas nevojës në kryerjen e detyrave të mia si Gjykatës i
15 Procedurës Paraprake.

16 Pres nga palët që t'u përmbahen këtyre pikave, të cilat
17 unë do t'i trajtoj një nga një. Nëse palët dëshirojnë të
18 diskutojnë ndonjë pikë tjetër që nuk është paraparë në kuadër
19 të seancës së parë -- të Paraqitjes së Parë, ftohen që këtë ta
20 bëjnë me anë të parashtrimeve me shkrim.

21 Së pari, z. Haradinaj, a mund t'ju kërkoj që të më
22 konfirmoni se e keni marrë Aktakuzën e Konfirmuar të datës 14
23 dhjetor 2020 në gjuhë që e kuptoni dhe flisni?

24 Ju mund të ngriheni në këmbë z. Haradinaj.

25 I AKUZUARI HARADINAJ: Po. Kam nënshkru një dokument që e

1 kam pa që është aktakuzë. Të drejtën të them, as lexu se kam.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.

3 Haradinaj. Por e keni marrë aktakuzës dhe aktakuza u është
4 bërë e ditur. A është kjo e saktë?

5 I AKUZUARI HARADINAJ: Po, ju keni marrë një nënshkrim që
6 unë kam pranë një dokument të tillë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.

8 Haradinaj.

9 Tani do të kërkoj nga Sekretarja e Gjykatës që të lexojë
10 akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar, sikurse
11 parashikohet në rregullën 39 të Ligjit -- nenin 39 të Ligjit
12 dhe rregullën 92.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në Aktakuzën e
14 Konfirmuar, Prokurori i Specializuar akuzon Nasim Haradinajn
15 me:

16 Pika 1: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
17 detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë, e
18 ndëshkueshme në bazë të neneve 401(1) dhe (5) të Kodit Penal
19 të Kosovës dhe nenit 15(2) të Ligjit;

20 Pika 2: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
21 detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjen në veprimin e
22 përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të neneve
23 401(2) dhe (3) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit
24 15(2) të Ligjit;

25 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale, e ndëshkueshme

1 në bazë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 15(2)
2 të Ligjit;

3 Pika 4: Hakmarrje, e ndëshkueshme në bazë të nenit 388(1)
4 të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 15(2) të Ligjit;

5 Pika 5: Shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes
6 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të
7 nxjerrë në procedura zyrtare, e ndëshkueshme në bazë të nenit
8 392(1) të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 15(2) të Ligjit;
9 dhe

10 Pika 6: Shkelje të fshehtësisë së procedurës, përmes
11 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
12 personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e ndëshkueshme në bazë
13 të nenit 392(2) dhe (3) të Kodit Penal të Kosovës dhe nenit
14 15(2) të Ligjit.

15 Këto vepra penale u kryen midis më së paku 7 dhe 25
16 shtatorit 2020.

17 Në lidhje me këto vepra penale, ekziston dyshim i bazuar
18 mirë se z. Nasim Haradinaj mban përgjegjësi penale, në bazë të
19 nenit 16(3) të Ligjit për:

20 a. kryerje të veprave penale në pikat 1 deri në 6, në
21 bazë të nenit 17 të Kodit Penal të Kosovës;

22 b. në bashkëpunim me Hysni Gucatin dhe të tjerë, në
23 veprat penale në pikat 1 dhe 3 deri në 6, në bazë të nenit 31
24 të Kodit Penal të Kosovës;

25 c. nxitje të kryerjes së veprave penale në pikat 1 deri

1 në 6, në bazë të nenit 32(1) të Kodit Penal të Kosovës;

2 d. nxitje të veprave penale në pikat 1 deri në 6, në
3 bazë të nenit 32(2) të Kodit Penal të Kosovës, dhe u tentua
4 kryerja e këtyre veprave penale;

5 e. nxitje të veprave penale në pikat 1 deri në 3 dhe në
6 pikën 6, në bazë të nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës, dhe
7 vepra të tilla penale nuk u kryen dhe as u tentua të
8 kryheshin;

9 f. ndihmë në kryerjen e veprave penale në pikat 1 deri
10 në 6, në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës;

11 g. marrëveshje për kryerje së bashku me z. Hysni Gucati
12 dhe të tjerë, të veprave penale në pikat 1 deri në 6, në bazë
13 të nenit 35 të Kodit Penal të Kosovës; dhe

14 h. tentim për të kryer veprat penale në pikat 1 deri në
15 4 dhe në pikën 6, në bazë të nenit 28 të Kodit Penal të
16 Kosovës.

17 Ju faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

19 Sekretare.

20 Z. Haradinaj, dua t'ju rikujtoj se kjo nuk është koha për
21 të kontestuar, kundërshtuar akuzat, por thjesht për të
22 konfirmuar se i keni të qarta akuzat. Ju do të keni mundësi të
23 bollshme së bashku me avokatin tuaj që t'i kundërshtoni
24 akuzat.

25 Z. Haradinaj, a i keni të qarta akuzat e paraqitura në

1 Aktakuzën e Konfirmuar ashtu siç ju lexuan nga Sekretarja e
2 Gjykatës?

3 I AKUZUARI HARADINAJ: I kuptova.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Haradinaj.

5 Tani më lejoni t'ju informoj për të drejtat tuaja para
6 kësaj Gjykate.

7 Ligji dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Provave ju
8 garantojnë disa të drejta. Unë do t'jua lexoj ato më të
9 rëndësishmet.

10 E para, ju prezumoheni i pafajshëm deri sa të provohet
11 fajësia juaj jashtë dyshimit të arsyeshëm. Në përcaktimin e
12 akuzave kundër jush, ju keni të drejtën e një gjykimi të
13 drejtë dhe publik në varësi të masave të urdhëruara për
14 mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

15 Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe në hollësi në
16 një gjuhë që e kuptoni për natyrën dhe arsyen e akuzave kundër
17 jush.

18 Keni të drejtën të keni kohën dhe lehtësimet e nevojshme
19 për përgatitjen e mbrojtjes dhe të komunikoni me avokatin
20 mbrojtës që keni zgjedhur vetë.

21 Keni të drejtën e gjykimit brenda një afati kohor të
22 arsyeshëm.

23 Dhe keni të drejtë të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
24 mbroheni përmes avokatit mbrojtës.

25 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat mbrojtës, dhe

1 atë falas në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për
2 pagesën e tij.

3 Keni të drejtë t'ju bëni pyetje ose dikush tjetër t'ju
4 bëjë në emrin tuaj pyetje dëshmitarëve kundër jush, dhe të
5 siguron praninë dhe marrjen e tyre në pyetje.

6 Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi falas në
7 qoftë se nuk e kuptoni apo flisni gjuhën që përdoret në
8 Gjykatë.

9 Keni të drejtë që të mos detyroheni të dëshmoni kundër
10 vetes apo të pranoni fajësinë.

11 Keni të drejtën të mbeteni i heshtur dhe nga heshtja juaj
12 nuk do të nxirret një përfundim negativ.

13 Gjithashtu keni të drejtë të bëni deklaratat pa betim në
14 lidhje me çështjen, dhe mund të paraqiteni vetë si dëshmitar
15 nën betim.

16 Keni të drejtë të paraqisni mocioneve paraprake për të
17 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për të
18 pretenduar defekte në formën e aktakuzës, dhe për të kërkuar
19 ndarjen e akuzave.

20 Keni të drejtë të merrni brenda 30 ditësh nga seanca e
21 sotme materialin mbështetës të aktakuzës që është dorëzuar për
22 konfirmim.

23 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e
24 dëshmitarëve të cilët Prokurori synon t'i thërrasë për të
25 dëshmuar në gjykim, dhe atë në një gjuhë që e flisni dhe e

1 kuptoni, përkatësisht në gjuhën shqipe.

2 Keni të drejtën të merrni menjëherë çfarëdo informacioni
3 që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme pafajësinë tuaj
4 apo të zbusë fajësinë tuaj, apo të ndikojë në besueshmërinë e
5 provave të Prokurorit të Specializuar, menjëherë sa ky
6 informacion të jetë në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë e
7 Prokurorit.

8 Keni të drejtë që të gjitha materialet dhe provat apo
9 faktet që ka Prokurori t'ju jepen përpara dhe gjatë
10 procedurave. Kjo e drejtë u nënshtrohet vetëm kufizimeve që
11 janë rreptësisht të domosdoshme dhe masave kundërbalancuese në
12 fuqi.

13 Keni të drejtën që të mos mbaheni në paraburgim për një
14 periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes tuaj, të
15 kërkonte rishikimin e vendimit për paraburgim, dhe të apeloni
16 vendime të tilla para Gjykatës së Apelit.

17 Keni të drejtë të apeloni drejtpërsëdrejti para Dhomës së
18 Apelit çdo vendim apo mocion paraprak që kundërshton
19 juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

20 Dhe keni të drejtë që të kërkonte leje të apeloni të
21 gjitha vendimet.

22 Z. Haradinaj, i dëgjuat të gjitha të drejtat më të
23 rëndësishme që i gëzoni në përputhje me kuadrin ligjor të
24 Dhomave të Specializuara. A i keni të qarta këto të drejta z.
25 Haradinaj?

1 I AKUZUARI HARADINAJ: Kokan nji nom të drejta. Po të
2 qarta i kam. Të faleminderit.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Haradinaj.

4 Dëshiroj t'ju informoj se sipas nenit 21(5) e Ligjit, ju
5 mund të përfaqësoni vetën sepse jeni në paraburgim. Është e
6 detyrueshme pra, të përfaqësoheni me mbrojtës të specializuar.

7 Unë kam për detyrë si Gjykatës i Procedurës Paraprake që
8 të siguroj që të drejtat tuaja për të pasur avokat të
9 respektohen. Për këtë unë kam marrë shënim dokumentin që ka
10 dorëzuar Administratorja që më informon për caktimin me kusht
11 të avokatit mbrojtës. Nga raporti i Administratores dhe nga
12 parashtrimet e avokatit tuaj kuptoj që ju nuk do të
13 përfaqësoheni nga ai vetëm sot por edhe për gjithë procedurën
14 dhe procesin gjyqësor, në përputhje me seksionin 14 të
15 Direktivës për Avokat Mbrojtës.

16 Z. Haradinaj, a mund të konfirmoni se z. Cadman është
17 caktuar për të gjithë periudhën e këtyre procedurave?

18 I AKUZUARI HARADINAJ: Po.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Haradinaj.

20 Nga kjo rrjedh që i akuzuari është i përfaqësuar me
21 avokat.

22 Tani do t'i kthehem mundësisë që i akuzuari të
23 vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë apo pafajësinë, në
24 përputhje me rregullën 92.

25 Z. Haradinaj, mbas -- ose brenda 30 ditësh nga dita e

1 sotme, ju do të ftoheni të pranoni fajësinë ose të
2 vetëdeklaroheni i pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës.
3 Nëse dëshironi, ju mund të zgjidhni që të pranoni fajësinë ose
4 të vetëdeklaroheni jo fajtor menjëherë.

5 Pra, ju pyes z. Haradinaj, nëse keni pasur mundësinë që
6 të diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me avokatin
7 tuaj, dhe a jeni i përgatitur që të vetëdeklaroheni në lidhje
8 me fajësinë ose pafajësinë sot.

9 Por e shoh që do të thotë diçka avokati juaj përpara,
10 kështu që ia jap fjalën z. Cadman.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë desha të them që unë jam
12 caktuar vetëm disa minuta përpara sesa të hyja në sallë, dhe
13 nuk kam pasur mundësinë të flas me z. Haradinaj. Vetëm 10
14 minuta kam pasur mundësi të flas me të.

15 Dhe kështu që do të na duhet njëfarë kohe që të kalojmë
16 aktakuzën dhe natyrën e akuzave kundër tij. Po e di që z.
17 Haradinaj do të flasë në Gjykatë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Haradinaj, i vij pyetjes
19 time. Juve mund të vendosni që të vetëdeklaroheni sot, ose
20 mund të prisni për afatin 30-ditor nga dita e sotme që të
21 vetëdeklaroheni.

22 Keni fjalën.

23 I AKUZUARI HARADINAJ: Z. Gjykatës dhe i nderuar, para se
24 të deklarohej a të mos deklarohej, dua të them se për mu dhe
25 këdo që ka vetëm një pikë logjike, nuk ka si kuptohet ndryshe,

1 vetëm se kjo për kori do të hjek vëmendjen e opinionit nga
2 vetja e saj dhe të kërkojë fajin krejt diku tjetër, pra, në
3 Kosovë. E që për ta, siç edhe po shihet këtu, Kosova dhe
4 qytetarët e saj janë fajtorë kujdestarë.

5 Pra, ne duhet të përgjigjemi sepse ju dolën sekretet e
6 tyre dhe u sollën mijëra kilometra larg në zyrat tona. Dhe mos
7 harroni, ato nuk ishin as një as dy fletë, po me mijëra fletë
8 e faqe.

9 Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së nuk ka pas
10 qasje dhe nuk ka, dhe as që mund të fajësohet për nxjerrjen
11 nga sirtarët e tyre të këtyre dokumenteve. Prandaj këtu në
12 vend timin do të duhej të ishin kolegët e tyre, e kësaj
13 Prokurorie, apo edhe ndonjëri nga vetë këta.

14 Nga ne dhe qëndrimet tona nuk keni se çka të pritni apo
15 të befasoheni, sepse qëndrimi ynë ka qenë publik dhe çdoherë
16 dyshues në Prokurorinë e këtyre Dhomave. Dhe këtë e kemi thënë
17 dhe po jua them edhe unë tash, mohimi i faktit duke anashkalu
18 se, kush i nxori nga sirtarët e kësaj Prokuroria këto
19 dokumente, kush i solli ato në Kosovë, kush na i solli ne në
20 selinë tonë?

21 Dhe tani për këtë ta mbajmë ne përgjegjësinë e tyre,
22 është çmenduri dhe aspak drejtësi, kur dihet shumë qartë
23 mendimi ynë për këto Dhoma. Pra, ne të akuzohemi për t'i larë
24 fajet e kësaj Prokurorie është absurd i kësaj Prokurorie në
25 drejtësinë e këtij shekulli.

1 Po jua them sinqerisht z. Gjykatës, se për mendimin tim
2 kjo Prokurori është së pari politike, selektive dhe e
3 njëanshme. Por tani me këtë veprim të tyre, po dyshoj dhe po
4 bindem se është edhe e korruptuar, sepse ndryshe nuk do t'u
5 dilte i gjithë ai material nga zyrat e tyre.

6 Dhe si përfundim, sheshazi, po del se kjo Prokurori pos
7 të tjerash ka edhe dy qëllime. Nën një, mundohet haptazi ta
8 njollosë dhe t'i humbë kuptimin luftës sonë çlirimtare dhe
9 luftëtarëve të saj, dhe nën dy, po mundohet të dënojë
10 përfaqësuesit e këtyre luftëtarëve.

11 E tani janë veteranë të luftës, pra, konkretisht kryetari
12 dhe nënkryetari i Organizatës së Veteranë të Luftës. Organ
13 këtu dhe organizatë kjo, e cila është formuar në bazë të
14 ligjeve të Kosovës, pra, të republikës së pavarur sovrane dhe
15 e patjetërsueshme dhe gjithashtu e njohur ndërkombëtarisht nga
16 mbi 100 shtete, e ndër të tjera edhe nga vetë shtetet e juve
17 që ju vini.

18 Të gjitha këto i thashë duke kontestuar çdoherë
19 juridiksionin, dhe tani edhe keqpërdorimin e mandatit kohor të
20 kësaj Prokurorie.

21 Ju faleminderit për durimin në dëgjueshmëri.

22 Ndërsa për kohën dhe deklarimin tem të fajësisë apo të
23 pafajësinë, do ta bëjë ose do të vendosë avokati.

24 Dhe nga sot, dhe nga ky moment po deklaroheh haptazi - le
25 të jetë edhe për dokumentin - unë më nuk flas por do të flas

1 vetëm përmes avokatit. Ju faleminderit.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Haradinaj.

3 E kuptoj nga ajo që thatë ju që nuk do të vetëdeklaroheni
4 sot.

5 Z. Cadman, a mund ta konfirmoni që e kuptova drejt nga
6 përkthimi?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Vetëdeklarimi do të bëhet herën
8 tjetër mbasi të kemi pas mundësinë të shikojmë materialin.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Duke pasur parasysh që z. Haradinaj nuk është
11 vetëdeklaruar sot, i kërkoj palëve të thonë mendimet e tyre,
12 në qoftë se kanë, për sa i përket përcaktimit të datave se kur
13 mund të caktohet data për vetedeklarimin.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë e di që është marrë parasysh
15 data 7 janar. Mbasi kam folur me avokatin e z. Gucati, ai më
16 duket ka kërkuar datën 8 janar, dhe kjo është e pranueshme
17 edhe për ne. Data 8 janar do të ishte e përshtatshme për të dy
18 avokatët.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

20 Znj. Prokurore.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne jemi të gatshëm të bëjmë
22 seancën qoftë në datën 7, apo datën 8 siç sugjeruan avokatët
23 mbrojtës, ose çfarëdo date tjetër që mund të vendosni ju.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Seanca për vetedeklarimin
25 do të caktohet më vonë.

1 Tani do të kaloj te gjuha e punës e këtyre procedurave.

2 Në urdhrin për caktimin e datës për këtë Paraqitje të
3 Parë, unë vendosa që gjuha do të jetë anglishtja. Unë informoj
4 palët se të gjitha udhëzimet dhe instruksionet që do të jepen
5 -- që janë dhënë në vendimin e 29 tetorit 2020, do të
6 vazhdojnë të jenë në fuqi për procedurat paraprahe.

7 Në këtë moment dëshiroj t'u kërkoj palëve nëse kanë
8 çështje të tjera që duan të ngrenë. I kujtoj palëve që të
9 njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë nga parashtrimet e tyre do
10 të kërkojë nxjerrjen e ndonjë informacioni konfidencial, në
11 mënyrë që të merren masat e duhura.

12 Të fillojmë me Prokurorinë dhe pastaj do t'jua jap fjalën
13 juve z. Cadman, më mbrapa.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne nuk kemi asgjë nga Prokuroria,
15 vetëm një vërejtje. Prokuroria vëren se avokati mbrojtës i z.
16 Haradinaj ka përfaqësuar edhe klientë të tjerë në procedurat
17 para Dhomave të Specializuara dhe ne kemi parasysh detyrimin e
18 mbrojtësit, në përputhje me nenit 28 të Kodit të Etikës
19 Profesione.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
21 Prokurore.

22 Z. Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit Prokurores që përmendi
24 detyrimet që kam unë. Besoj e keni parasysh që komunikimi që
25 kam bërë me Administratoren dje, unë e kam bërë krejt të qartë

1 që unë i di detyrimet e mia. Kam diskutuar me z. Haradinaj dhe
2 personat e tjerë që i kam përfaqësuar në të kaluarën. S'ka
3 asnjë lloj konflikti, megjithatë unë do të vazhdoj që t'i
4 zbatoj obligimet e mia.

5 E vetmja gjë që duhet të ngrihet këtu si çështje, ju i
6 nderuar Gjykatës keni caktuar si afat për trajtimin e çështjes
7 të paraburgimit para gjykimit. Duke pas parasysh se unë sapo
8 jam caktuar -- dhe avokati i mëparshëm nuk ka përgatitur
9 ndonjë kërkesë në lidhje me urdhrin tuaj.

10 Unë e diskutova këtë çështje me Prokurorinë, dhe i thashë
11 atyre që do të kërkojë pak më shumë kohë dhe ata nuk kanë
12 kundërshtim. Dhe me sa di unë, i nderuar Gjykatës, ju duhet të
13 merrni vendim më datë 27 dhjetor por -- pra, koha do të ishte
14 shumë e kufizuar. Për këtë arsye na duhen të paktën pesë ditë
15 që të bëjmë parashtrimin tonë me shkrim.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

17 Në lidhje me këtë çështje, avokati mbrojtës i mëparshëm i
18 z. Haradinaj kishte dijeni për afatin e ditës së sotme, dhe në
19 përputhje me nenin 25 të Kodit të Etikës Profesionale, ishte
20 detyrimi i tij që ta transferonte çështjen tuaj dhe t'ju
21 informonte për afatet përkatëse në mënyrë që të mos kishte
22 asnjë lloj pengese në përfaqësimin e z. Haradinaj.

23 Për çështjen që ngritët ju, ligji parashikon një
24 paraburgim -- një shqyrtim të paraburgimit brenda dy muajsh.

25 Në rastin e z. Haradinaj, ky rishikim i afatit të

1 paraburgimit do të bjerë më datën 27 dhjetor. Palët janë
2 informuar paraprakisht që të bëjnë parashtrime dhe unë edhe
3 çështjen e sotme, seancën e sotme e shtyva me kërkesën e tij.

4 Fatkeqësisht, për shkak të këtij afati dy muajsh për
5 bërjen e rishikimit të vendimit të paraburgimit, unë nuk mund
6 t'ju jap më shumë kohë juve sepse për ndryshe nuk do të kem
7 kohë të marrë vendimin. Megjithatë nuk ju ndalon asgjë që në
8 fazë të mëvonshme të bëni kërkesë për lirim të ndërkohshëm që
9 është në përputhje me Rregulloren dhe me Ligjin.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Me respektin më të madh, i nderuar
11 Gjykatës, në lidhje me kërkesën për caktimin, ajo u bë dje
12 pra, caktimi im. Unë mbërrita këtu mbrëmë në darkë, por
13 emërimi akoma nuk ishte bërë zyrtar. Dhe unë u njoftova para
14 se të vija këtu se ky emërim u bë.

15 Z. Martens, nuk më dha asnjë dokument derisa unë u
16 caktova zyrtarisht pra, si avokat mbrojtës. Kështu që akoma
17 nuk kam marrë asnjë dokument deri tani që flas.

18 Kam vetëm ato që gjenden në faqen e internetit lidhur me
19 këtë çështje, që është një material i disponueshëm publikisht.
20 Kam folur vetëm për 10 minuta me z. Haradinaj sot në mëngjes.

21 Pa dyshim që ne do ta kundërshtojmë paraburgimin e tij
22 dhe atij do t'i jepet mundësia ta bëjë këtë në një kërkesë me
23 shkrim. Shpresoj që nuk do të cenohemi nga kjo në çdo
24 mosmundësi e avokatit të mëparshëm ta kishte bërë këtë gjë,
25 apo të paraqiste materialin për këtë qëllim.

1 Duhet të na jepet mundësia. Në qoftë se ju i nderuar
2 Gjykatës nuk do të na jepni pesë ditë të tjera më shumë,
3 kërkoj të paktën kohë shtesë, të paktën deri të hënën, që të
4 kem mundësi të bëj kërkesë. Për të mos ju cenuar dhe kohën
5 tuaj për të marrë vendimin deri në 27 dhjetor.

6 Unë -- kështu që jam në dorën tuaj.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Znj. Prokurore, ç'keni për të thënë për këtë kërkesë?

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Prokuroria konstaton se Gjykatësi
10 -- urdhri i Gjykatësit të Procedurës Paraprake është një --
11 për parashtrim deri në -- i nxjerrë në 9 tetor, është publik.
12 Ne e dimë që koha ishte sot, afati.

13 Gjithsesi ne si Prokurori e lëmë në dorën tuaj të drejtën
14 për të dhënë apo jo zgjatjen e afatit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

16 Prokurore.

17 Z. Cadman, më vjen vërtet shumë keq dhe e kuptoj
18 pozicionin tuaj, por në këtë rast urdhri për parashtrime ishte
19 publik dhe ishte detyrë e avokatit të mëparshëm të z.
20 Haradinaj për të përgatitur parashtrimet.

21 E kuptoj që ju jeni caktuar vetëm dje, sot në fakt, por
22 të paktën ju keni -- e keni kontaktuar institucionin tonë dje
23 për këtë çështje. Atëherë ju ftoj të lidheni me avokatin e
24 mëparshëm, sepse ai e kishte për detyrë t'i bënte këto
25 parashtrime dhe t'i paraqiste sot.

1 Unë duhet të jap një vendim dhe duhet të informohem dhe
2 nuk mund të pres më shumë.

3 Po vazhdojmë tani me disa çështje procedurale.

4 Së pari, ju informoj se kam ndërmend të planifikoj një
5 Konferencë për Ecurinë e Çështjes, sipas rregullës 96, për t'u
6 mbajtur të enjten në 7 janar. Qëllimi është për të shqyrtuar
7 ecurinë e çështjes dhe për të organizuar shkëmbime midis
8 palëve për të siguruar përgatitjen e shpejtë për gjykim.

9 Z. Haradinaj, dëshiroj t'ju kujtoj se keni të drejtë për
10 të qenë i pranishëm në këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjes
11 me avokatin tuaj. Por me pëlqimin tuaj me shkrim dhe pasi të
12 keni marrë këshilla nga avokati, sipas rregullës 96(2),
13 Konferenca për Ecurinë e Çështjes mund të ndiqet, nga ju në
14 person me avokatin që të marrë pjesë nëpërmjet
15 videokonferencës; nga avokati juaj, kurse ju z. Haradinaj të
16 merrni pjesë nëpërmjet linkut të videokonferencës; por mund të
17 bëhet gjithashtu në mungesën tuaj me praninë e avokatit tuaj
18 apo duke marrë pjesë përmes linkut në videokonferencë.

19 Tani dëshiroj t'i pyes palët se ç'mendojnë për datën e
20 propozuar për Konferencën lidhur me Ecurinë. Ju e përmendët më
21 përpara, por do të doja ta përsërisni dhe njëherë në qoftë se
22 7 janari është një datë e mundshme për ju.

23 Znj. Prokurore.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne jemi të disponueshëm në çdo
25 kohë që ju do ta vendosni z. Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Z. Cadman.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë jam i disponueshëm ose në 7 ose
3 në 8, kurdoherë që të jetë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Do të merrni një urdhër ku do të përfshihet afati dhe
6 programi.

7 Mbas Konferencës për Ecurinë e Çështjes do të jap vendim
8 për detyrimet që ka Prokuroria për të bërë materialet e
9 njohura, në përputhje me rregullën 102. Në urdhrin për
10 planifikimin e Konferencës do t'i ftoj palët të bëjnë
11 parashtime me shkrim përpara seancën dëgjimore për këtë temë
12 dhe për çdo çështje që ata dëshirojnë të ngrenë gjatë
13 Konferencës për Ecurinë e Çështjes.

14 Gjatë kohës që ju do të mbeteni i paraburgosur z.
15 Haradinaj, dua t'ju informoj se ju mund ta kundërshtoni
16 paraburgimin në përputhje me rregullën 57. Kjo do të trajtohet
17 në vendime me shkrim.

18 Siç thashë dje në vendimin për ripërcatimin e çështjes,
19 ftoj Mbrojtjen e z. Haradinaj të na thotë se kur njoftimi i
20 tij për pëlqimin lidhur me këtë Konferencë, që ka numrin F0080
21 //siç u përkthye// që u paraqit dje si konfidenciale, mund të
22 riklasifikohet si publik, apo nëse ai synon të parashtrojë një
23 version publik të redaktuar.

24 A keni mundësi t'i përgjigjeni sot?

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Për fat të keq, jo. Unë do ta

1 shikoj dhe do t'ju përgjigjem me shkrim në momentin e duhur.

2 E vetmja çështje që duhet të ngre, meqë jam në këmbë,
3 duhet të them se avokati i z. Gucati në kundërshtimin e tij
4 për paraburgimin ka kërkuar një seancë dëgjimore. Edhe unë i
5 bashkëngjitem kësaj. Edhe unë kam ndërmend të bëj një
6 parashtrim në fund të ditës së punës sot për këtë gjë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Cadman.

8 Në këtë drejtim dua t'u kujtoj palëve se parashtrimet
9 duhet të paraqiten si publike, përveç kur ka arsye që të
10 mbahet informacion që përmbajnë ato. Në këtë rast, sipas
11 rregullës 82, pala duhet të parashtrojë arsyet për
12 klasifikimin, kodin konfidencial.

13 Gjithashtu, i urdhëroj palët të bëjnë parashtrime apo të
14 vënë në dukje mendimet e tyre lidhur me riklasifikimin e
15 parashtrimeve. Kjo do të thotë që palët ftohen të deklarojnë
16 mendimet e tyre për këtë çështje. Parashtrimet nuk mund të
17 riklasifikohen *proprio motu* nga palët por vetëm në bazë të
18 udhëzimeve gjyqësore.

19 Gjithashtu dua të shtoj diçka lidhur me median dhe
20 informacionin konfidencial. Unë vura në dukje me njëfarë
21 shqetësimi se gjatë ditëve të fundit media ka raportuar
22 informacion në lidhje me datën e vendimit të konfirmimit dhe
23 të akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar, që në fakt nuk janë bërë
24 -- nuk ishin bërë ende publike në atë kohë.

25 Në këtë drejtim, dëshiroj t'u kujtoj të gjitha palëve dhe

1 të akuzuarit të respektojnë natyrën konfidenciale të disa
2 informacioneve të këtyre procedurave.

3 Dëshiroj gjithashtu t'u vë në dukje se Paraqitja e Parë e
4 z. Haradinaj bëhet sot, në këtë kohë, pas dy vendimeve që kanë
5 ripërcaktuar kohën dhe datën. Ndërsa kjo kohë, duke marrë
6 parasysh se kjo është Paraqitja e Parë e të akuzuarit, unë i
7 kam lejuar si rast përjashtimor këto ndryshime. Kërkesa të
8 mëtejshme për rindryshim -- për ndryshimin e datës do të bëhen
9 vetëm për arsye të forta. Ripërcaktimi i një seancë dëgjimore
10 kërkon shumë punë për shumë njësi të Dhomave të Specializuara,
11 prandaj këto raste duhet të mbahen në nivel minimal.

12 Së fundi, dëshiroj t'ju kujtoj se pushimi i Dhomave
13 fillon në datën 21 dhjetor 2020 dhe përfundon në 1 janar 2021.
14 Gjatë kësaj periudhe kohore unë do të përgjigjem vetëm për
15 çështje urgjente. Çështjet jourgjente duhet -- i duhen
16 adresuar Gjykatës Themelore pas pushimit.

17 I falënderoj palët dhe me kaq përfundon sot seanca.
18 Dëshiroj të falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët dhe
19 personelin e sigurisë për ndihmën që na kanë dhënë.

20 Seanca përfundon.

21 --- Seanca e Paraqitjes së Parë përfundon në
22 orën 11.41

23

24

25